

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

*Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

Një ankesë kundër: **KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVES sh.a.**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **KEK-25-3009-1-1-1**

Sa i përket tenderit për **Furnizim me Hidrazinë dhe Dioksid klori Lot 1- Furnizim me Hidrazinë Lot 2- Furnizim me Dioksid klori**

### ANKESË

#### 1. Identifikimi i ankuesit\*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	<b>SAMET MESTANI B.I.</b>
NUI	<b>810589674</b>
Adresa	<b>Prizren, Nr.37, Pejës</b>
Vendi	<b>Prizren</b>
Kodi postar	<b>20000</b>
Numri Telefonit	
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	<b>Samet Mestani</b>
Adresa elektronike	<b>samet.mestani@hotmail.de</b>
Data e parashtrimit të ankesës	<b>14.08.2025</b>

*\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

#### 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

Emri i avokatit  
Adresa e plotë  
Numri i Telefonit  
Numri i faks-it  
Adresa elektronike

### 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

**Lot 2- Furnizim me Dioksid klori ClO2**

**Titulli: Furnizim me Hidrazinë dhe Dioksid klori**

**Lot 1- Furnizim me Hidrazinë**

**Lot 2- Furnizim me Dioksid klori**

**Nr i prokurimit: KEK-25-3009-1-1-1**

**Njoftimi për kontratë: 15.04.2025**

**Hapja e ofertave: 04.06.2025**

**Njoftimi mbi vendimin e AK-së: 25.07.2025**

### 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

### 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

### 6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

**Paraqitja e kërkesës për rishqyrtim: 30.07.2025**

**Vendimi nga AK mbi kërkesën për rishqyrtim: 04.08.2025**

## **7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues**

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

Ligji Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, I ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L092 (Versioni i Konsoliduar), Nenet si në vijim:  
Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi  
Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

RREGULLORE PËR PROKURIMIN PUBLIK - Versioni i konsoliduar  
Paragrafi 7.6.1 i Neni 7 - Informata Sekrete afariste dhe Qasja në Dokumentacion

*\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjorbë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

## **8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

Me date 04.06.2025 kemi dorëzuar ofertën për këtë aktivitet të prokurimit, konform të gjitha kushteve dhe kriterëve të dosjes së tenderit. Me 25.07.2025 kemi pranuar Letrën Standarde për Tenderuesit e eliminuar dhe Njoftim mbi Vendimin e AK për rekomandim me kontratë Operatorëve Ekonomik AG Petroleum SH.P.K. Anton Çeta p.n. Kaçanik i Vjeter, 71000, Kaçanik për LOT 2 – Furnizim me Dioksid klori.

Na është lejuar qasja në dokumentacionin zyrtar me datë 26.07.2025 ndërsa kemi kërkuar përsëri me datë 28.07.2025, dhe pas shqyrtimit të Ofertës të OE të rekomanduar për kontratë, në bazë të dokumentacionit duke krahasuar me kërkesat si në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë kemi konstatuar se Komisioni Vlerësues kundërligjshëm ka rekomanduar për fitues një OE të papërgjegjshëm me këto shkelje:

### **Pretendimi 1**

I gjithë dokumentacioni që dëshmon kualitetin e produkteve është klasifikuar si sekret afarist, andaj Bazuar në RREGULLORE PËR PROKURIMIN PUBLIK - Versioni i konsoliduar, paragrafi 7.6.1 Autoriteti Kontraktues nuk do të klasifikojë një informatë si sekret afarist, nëse OE nuk e ka plotësuar Aneksin 3 të Dosjes së tenderit me të gjitha informacionet e kërkuara në këtë formular, me theks të veçantë poqëse nuk i ka paraqitë të gjitha faktet dhe argumentet me të cilat OE dëshmon se zbulimi i një informacioni do t'i shkaktojë dëm material biznesit të tij.

Në lidhje me këtë OE i propozuar për kontratë nëse nuk i ka paraqitë asnjë fakt dhe

argument (nuk na është ofruar ndonjë fakt apo argument) me të cilat OE dëshmon se zbulimi i një informacioni do ti shkaktojë dëm material biznesit të tij ju si AK nuk duhet që ti klasifikoni si sekret afarist dokumentet që janë klasifikuar si të tilla, edhe nëse ato janë të klasifikuara si të tilla nga OE.

Duke pasur parasysh se përdorimi i këtyre produkteve – artikujve mund të shkaktojë helmime tek përdoruesit nëse nuk janë adekuate, dokumentet që dëshmojnë se këto produkte lejohen për përdorim dhe janë sipas specifikacionit teknik nuk duhet të klasifikohen si sekret afarist e sidomos CERTIFIKATAT E PRODUKTIT.

Bazuar në kërkesën e datës 28.07.2025 që nëse nuk na lejohet të marrim nga një kopje të CERTIFIKATAVE TË KUALITETIT TË PRODUKTEVE për secilin LOT, të vendit të origjinës dhe autorizimet nga prodhuesi, ju lutem na lejoni që ti shikojmë ato në prezencën tuaj, kjo qasje nuk na është lejuar.

Bazuar në interpretimin e KPRR-së:

31. 24.10.2023 Cilat janë veprimet e AK në rast të një kërkesë nga OE për qasje në dokumente zyrtare?

Në pajtim me nenin 87, paragrafin 2, nën-paragrafin 2.8 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 (në tekstin e mëtejshëm “LPP”) duke u bazuar në pyetjen e parashtruar, KRPP ofron interpretimin ligjor të nenit 10 dhe 11 të këtij ligji, si në vijim:

7.5 Informacionet të cilat mund të klasifikohen si informacione sekrete afariste janë:

a. Informacionet në lidhje me pasqyrat ekonomike dhe financiare, neni 68 i LPP-se; dhe  
b. informacionet në lidhje me mundësitë teknike dhe/ose profesionale, neni 69 i LPPkonfidenciale vetëm nëse:

a. Operatori Ekonomik, përveç se i identifikon (“markon”) dokumentet si “sekret afarist” gjatë ngarkimit të tyre në Sistemin Elektronik të Prokurimit Publik, i njëjti duhet të plotësojë Aneksin 3 të Dosjes së Tenderit “Kërkesa për sekret afarist”.

b. Nëse Operatori Ekonomik konsideron që informatat e dorëzuara sipas nenit 68 dhe 69 të LPP-së të trajtohen nga Autoriteti Kontraktues si informata sekrete afariste në përputhje me nenin 11 të LPP-së, i njëjti duhet të shkarkojë nga sistemi Aneksin 3 “Kërkesa për sekret afarist”, të plotësojë duke dhënë arsyetimet për secilin dokument të identifikuar si “sekret afarist”, nënshkruaj dhe vulos aneksin, si dhe ta ngarkojë bashku me dokumentet tjera të tenderit të tij.

Ndërsa,

Sipas nenit 7.7 të RRPP, Është përgjegjësi e AK-së për të siguruar që pjesët të cilat janë deklaruar si sekret afarist nuk janë vënë në dispozicion Operatorëve të tjerë ekonomik. Për këtë qëllim, AK duhet të veprojë në përputhje me paragrafët 4 dhe 5 të nenit 11 të LPP-së. Me këtë veprim duke mos i kërkuar fakte dhe argumente OE të propozuar për kontakt se pse këto dokumente janë klasifikuar si sekret afarist, ju si AK e keni shkëlur Neni 7 - Informata Sekrete afariste dhe Qasja në Dokumentacion të RREGULLORE PËR PROKURIMIN PUBLIK - Versioni i konsoliduar duke mos na lejuar qasje në këto dokumente.

## **Pretendimi 2**

Ne dokumente ne te cilat kemi pasur qasje kemi gjet shume parregullsi qe nuk korrespondojne me kualiteti e produkteve te kerkuara nga AK KEK ne Tenderin KEK-25-3009-1-1-1

1. Deklarata e prodhuesit dhe Deklarate e origjines:

OE AG Petroleum ne keto te dy deklarata garanton se eshte prodhues i produktit eshte kompania eOx Balkan shpk me seli ne Kaqanik te vjeter ne rrugen Anton Çetta.

Nese kompania eOx Blakan na qenka prodhues i produktit dhe produkti qenka me origjin nga Kosova OE AG Petroleum nuk e ka dorezuar çertifikaten ISO 9001 si eshte kerkuar ne dosjen e tenderit. Ky OE ka dorezuar nje dokument nga Ministria e ambientit e qe nuk eshte kerkuar ne dosjen e tenderit.

Ne deklaraten e origjines garanton origjinen e produkteve dhe cilesin ne perputhshmeri me standardet evropiane dhe kosovare.

Cilesia produkteve dhe sigurohet permes çertifikates per menaxhimin e kualiteti dhe standardeve EN me numer te caktuar gjë qe nuk i ka dorëzuar.

2. Produkti duhet te jete sipas standardit EN 12761:

Ky standard vlen vetem per dioxidin e klorit dhe jo per Komponente A dhe komponenten B.

Ne dosjen e Tenderit KEK-25-3009-1-1-1 eshte kerkuar Komponent A dhe Komponent B dhe JO DIOXID KLORI.

Andaj per te perfituar tretesir dioxid klori me perqendrim te caktuar p.sh 0,3% apo 0,75% sipas standardit EN 12761 patjeter duhet qe Komponenta te plotesojne cilesin e standardeve EN 938.

Pasi qe Komponent B ka shumë në treg mvaresisht nga destinacioni dhe ne nuk e dim se me cilen ka ofertuar per me precizue numrin e standardit por duhet patjeter me plotesue standardi EN me numer te caktuar.

OE AG Petroleum askund nuk ka dokumentuar se ka ofertuar me produkte cilesore per perpunimin e ujit si eshte kerkuar nga AK KEK uje me kualitet te ujit te pijes.

Ne kete raste i bie sikur AK me kerkua Ari dhe baker per prodhimin e nje legure ari 14 karat e OE AG Petroleum me ofertue me Hekur dhe Baker.

3. Deklarata per specifikacionet teknike:

OE, AG Petroleum, edhe pse I ka deklaruar specifikacionet e produkteve te veta si sekret afarist Deklaron se specifikacionet teknike te mallrave te ofruara perputhen me ato te permendura ne Anexin I.

Une dyshoj se ky Tender KEK-25-3009-1-1-1 eshte i kurdisur per OE AG Petroleum sepse te njejtat specifikacione të gabuara ky OE i ka pase edhe per KRU-Bifurkacioni ne Ferizaj e edhe per Termocentralin Kosova B.

Keto specifikacione per Komponenten A dhe per Komponenten B nuk korrespondojne me vlerat specifikuese per keto dy produkte.

Komponenten A

Sopecifikacioni I OE AD Petroleum

<b>Komponetja A koncentratit ClO<sub>2</sub></b>	<b>0.75%</b>
Gjendja	e lëngët
Ngjyra	E verdh ne te gjelbert
Era	karakteristike
Temperatura e zberthimit	> 170 °C
Pesha specifike	1.20 g/cm <sup>3</sup>
PH	> 12 në 20 °C
Tretshmëria	E plot

Tab.1 Karakteristikat Kimike-Fizike komponetja A

Komponenta A me 0,75% dioksid klori eshte shume e dobet, 20 here me e dobet ne krahasim me ate qe ne kemi ofertua, 15% ClO<sub>2</sub> ose 25% NaClO<sub>2</sub>.

Nga kjo qe po shihet se juve ne vende te 21 T Komponent A me 15% ClO<sub>2</sub> Ju duhen 420T

Parameter	Test Method	Value	Unit
*Appearance	visuell	clear, yellowish liquid	
*Density at 20°C	DIN 51757	1,20 g/cm <sup>3</sup>	g/cm <sup>3</sup>
*Content	Iodometry	24,0-26,0	%
*Content-CIO2	Iodometry	14,5–16,6	%
*pH-value at 20°C:	Potentiometry	> 12	

Komponenta B  
 Specifikacioni i OE AD Petrololeum

<b>Komponentja B koncentrat i ClO2</b>	<b>0.75%</b>
Gjendja	e lëngët
Ngjyra	Pa ngjyr
Era	Karakteristike e lehtë
Temperatura e zërthimit	Nuk është e përcaktuar
<b>Pesha specifike</b>	<b>Nuk përcaktohet</b>
<b>PH</b>	<b>Nuk është e përcaktuar</b>
Tretshmëria	E plot
Ambalazhi i plastikës	1000 L

Tab.3 Karakteristikat Kimike-Fizike të Komponentja B

OE AG Petroleum ka ofertuar Komponentin B gjithashtu me 0,75% dioksid klori, ClO<sub>2</sub>. Komponenta B NUK GUXON TE PERMBAJE DIOKSID KLORI KURRESESI SEPSE ESHTE HELM,

Dhe jam i sigurtë që punëtorët e KEK të cilët kanë punuar me dioksid klori janë të helmuar dhe me siguri kanë kërkuar ndihmë mjekësore.

Nëse pesha specifike (emertim dhe më shumë tash duhet Densiteti në 20°C) dhe vlera e pH se janë të pa përcaktuara, atëherë nuk mund të dihet se me çfarë Komponent B ka ofertuar?

Çfarë përmbajtje dhe çfarë përqendrimi?

Parameter	Test Methode	Value	Unit
*Color	visual	Colorless	
*Condition	visual	Liquid	
*Odor		odorless	
*Density at 20°C	DIN51 757	1,10– 1,16	g/cm <sup>3</sup>
*Content	Titration	13,0-16,0	%
*Conductivity at 20°C	Konduktometri	280 -320	mS/cm
*pH-value at 20°C:	Potentiometry	<2	

Duke u bazuar edhe në çmimin e ofertes ku para dy vite ka qenë mbi 3752 Euro për 1000 kg këtë vit ka zbritur në 1711 Euro për 1000 kg lë të kuptohet se ky OE ka ofertuar me produkte JO cilësore dhe të holluara, pra me 0,75% ClO<sub>2</sub> dhe JO sipas njerit nga standardet EN.

4. Tek Katalogu Identifikimi i rrezikut shënjat e rrezikut na bëjnë me dije se MSDS për

Komponenten A dhe Komponenten B janë të pavlefshme dhe të pa përdorshme gjë që në dyshojmë se janë të manipuluar. Këto shenja të rrezikut nuk përdoren nga Data 20. Januar 2009.



5. Gjithashtu tek katalogu menyrë e përgaditjes së Eoxide 0,75% na bëjnë të kuptojmë se ky OE, AG Petrol, nuk ka as dijeni shkencore, as kapacitete profesionale dhe teknike për prodhimin e dioksidit të klorit, Eoxide-0,75%.

6. Lista e dokumenteve të tenderit mbështetës:

Sipas kësaj liste OE AG Petroleum paska dorëzuar edhe çertifikatën e analizës konform EN 12761.

- OE AG Petroleum por edhe OE të tjera kanë ofertuar për Komponenten A dhe Komponenten B e jo për dioksidin e klorit për të cilin vlen standardi EN 12761. Lëshimi i çertifikatës së analizës për një produkt që nuk e prodhon, nuk oferton është falsifikim i dokumentit.

Dioksidin e klorit e prodhon AK, KEK duke e përzier Komponenten A si donator të dioksidit të klorit dhe Komponenten B me raporte të caktuara (1:2). Kjo i bën sikur një çifti të ri pas ndalesës së martesës të lëshohet çertifikata e lindjes për femijën që ende nuk ka lindë.

Edhe çertifikatat e analizës A, B, A B konsiderohen të falsifikuara nëse lëshohen për produktet që ende nuk janë prodhuar dhe nuk janë dërguar.

Duke u bazuar në të gjitha gjetjet tona në dokumentet që kemi pasqaruar konsiderojmë se komplet dokumentet e ofertuesit, OE AG Petroleum janë JO VALIDE, TË PA SAKTA e DISA EDHE TË FALCIFIKUAR.

Duke u bazuar në të gjitha faktet që u cekën më lartë kërkojmë nga AK që ta rishqyrton edhe një herë vendimin sepse është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, I ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 (Versioni i Konsoliduar), konkretisht e:

Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve si dhe

RREGULLORE PËR PROKURIMIN PUBLIK - Versioni i konsoliduar

Paragrafi 7.6.1 i Neni 7 - Informata Sekrete afariste dhe Qasja në Dokumentacion

Pretendimi ynë është i bazuar në dëshmi dhe fakte të cilat lehtësisht mund të verifikohen,

dëshmi të cilat i potencuam edhe më lartë, prandaj kërkojmë që NJOFTIM MBI

VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES –B 58 i këtij tenderi të anulohet dhe të

aprovohet kërkesa jonë për rivlerësim të tenderit, dhe pas një vlerësimi korrekt të

shpallemi NE si fitues i tenderit në fjalë.

Duke u bazuar në faktet që u përmenden më lartë, kërkojmë nga ju që të shqyrtoni

Kërkesën tonë për Rishqyrtim në mënyrë meritore dhe të nxjerrni këtë:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar Ankesa e SAMET MESTANI B.I. të anulohet "Njoftim mbi

vendimin e autoritetit kontraktues" për këtë aktivitet të prokurimit dhe njëkohësisht

kërkojmë që të ktheni tenderin në rishqyrtimin dhe rivlerësimin e këtij aktiviteti të

prokurimit sipas dispozitave të LPP-së dhe duke u bazuar në kërkesat e FDT-së dhe të

njoftimit për kontratë, duke na rekomanduar kompaninë tonë fituese pasi që supozojmë që

jemi të kompletuar për këtë projekt.

## 9. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.*

**Konsiderojme që kemi bërë shpenzime materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim, për përgatitjen e ankesës si dhe dëmtime tjera në fitimin e pritur, vlerë të referencave, imazh dhe dëmtime tjera që mund të ndodhin**

## 10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

*\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*